

Data 09.11.2023

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: "BLERJE MOTORRË PËR POLICINË BASHKIAKE".**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 42111000-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 14.996.663 (katërbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa tvsh, me objekt: "Blerje Motorre për Policinë Bashkiake",** vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të V.K.B-së Nr. 126 dt 23.12.2022 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023"

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".*

## **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

*Argumentimi:* Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: .... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;". Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

**2.2.2** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron

aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të furnizimeve të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave, shërbimeve të realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave, shërbimeve të realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).*

**Argumentimi:** Kërkesate mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ,

“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

*“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

- Standardi ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca/profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për furnizim, ofrim shërbimesh dhe për proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit, sigurimi i konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për standardin ISO 9001 ose ekuivalent me të, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës në të gjithë komponentët e saj.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori të autorizuar ku të vërtetohet lidhja me prodhuesin, për mallrat objekt prokurimi. *Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna te plota te prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

**Argumentimi:** *Duke qenë se autoriteti kontraktor, është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për furnizimet e kryera, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës, volumit dhe objektit të prokurimit, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar për komponentë të rëndësishëm dhe thelbësorë të kontratës, shërben si garanci në çfarëdo rasti anomalie të mundshme përgjatë afatit të ekzekutimit të kontratës, si dhe garanton aktivizimin e shërbimeve të prodhuesit, sic janë ato të suportit dhe mbështetjes teknike e administrative.*

*Referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmimeve nga prodhuesi/ distributori i autorizuar për zërat e kërkuar sipas kriterit, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.*

*Autorizimi i prodhuesit është nje dokument i rëndësishëm, pasi përvecse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.*

*Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për*

*prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/ broshurë, ku të përshkruhen specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi në përputhje me ato të kërkuara nga AK. Në katalogë/ broshura, duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 5 të DST. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Fleta ose fletët e katalogut/broshurës, që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6 germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) të ndryshuar ku citohet: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

...  
b. *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose..”*  
...”

*Kërkesa për paraqitjen e katalogëve, jep mundësinë për kryerjen e verifikimeve për përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara, paraqitur nga operatorët ekonomikë, në rast se janë në përputhje me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.*

*Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së motorëve (jo më pak se një vit), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e tyre konform specifikimeve teknike. Operatori ekonomik do të marrë përsipër zëvendësimin e çdo pjese në rast defekti që vjen nga prodhuesi për një periudhë jo më pak se një vit nga dita e dorëzimit të mallit dhe të marrë përsipër çdo riparim që lidhet me defekte të prodhuesit.

**Argumentimi:** Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe të mbulojnë demtimet brenda periudhës së garancisë. Kriteri i kërkuar në lidhje me deklaratën, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Neni 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.3.6** Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar shërbimin e riparimit, mirëmbajtjen, suportit e garancisë përgjatë periudhës së parashikuar, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë 1 (një) punonjës të diplomuar si Inxhinier Mekanik, i cili duhet të jetë pasqyruar në Listëpagesat e Shoqërisë minimalisht për 2 (dy) mujorin e fundit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diploma përkatëse për punonjës të kërkuar;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emër mbiemër)/ profilin e punonjësit nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për 2 (dy) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet punonjësi i kërkuar si më sipër.

Shënim: Kriteri 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 40, pika 5:

*“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*

*... ”*

Kërkesa e autoritetit kontraktor për “1 (një) punonjës që është i diplomuar si Inxhinier Mekanik” është në përputhje dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës objekt prokurimi, konkretisht për të garantuar shërbimin e riparimit, mirëmbajtjen, suportit e garancisë përgjatë periudhës së parashikuar.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një servis të përshtatshëm për kryerjen e shërbimeve, mirëmbajtjen apo riparimin e mallrave objekt prokurimi gjatë periudhës së garancisë. Ambienti/ servisi duhet të jetë brenda territorit të Bashkisë së Tiranës. Për këtë, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë/ huapërdorjen/ qiramarrjen si më poshtë:

**a. Dokumentacion që vërteton pronësinë:**

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

**b. Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:**

- Kontratë huapërdorje (e vlefshme).

**c. Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:**

- Kontratë qiraje (e vlefshme).

**Argumentimi:** Referuar preventivit të administruar në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi, ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e tyre konform specifikimeve teknike, si dhe do të marrë përsipër zëvendësimin apo riparimin e çdo pjese në rast defekti që vjen nga prodhuesi për një periudhë jo më pak se një vit nga dita e dorëzimit të mallit. Pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë që do të marrin përsipër kryerjen e këtyre shërbimeve duhet të kenë një ambient (servis) për realizimin e këtyre shërbimeve ç'ka do të sillte detyrimisht realizimin me sukses të këtyre shërbimeve.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që disponon Licencë për ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1. për “Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

**Argumentimi:** Kjo license është kërkuar duke marrë shkas nga llojet e shërbimeve që do të ofrohen dhe konform VKM Nr 538 dt 26.05.2009 për “Licencat edhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullimi të tjera nënligjore të përbashkëta” (e ndryshuar). Kjo lloj license mbulon shërbimet si më poshtë vijon ndër të cilat përfshihen edhe shërbimet objekt prokurimi:

*"Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove", me kodin VII.3.B.1, ku përfshihen:*

a) riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

b) riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

c) riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

ç) riparimi dhe mirëmbajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

d) blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkiove;

dh) mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

Nisur nga fakti se mjetet motorike të shërbimit të përditshëm kërkojnë mirëmbajtjen dhe shërbimin si dhe riparim profesional në rastin e mbulimit të garancisë, lind nevoja që subjekti ofertues që jetë i pajisur me licencën e servisit kategoria VII.3.B.1 lëshuar nga QKL. Sipas ligjit, cdo subjekt i cili do të garantojë servisin e mjeteve sipas kontratës, duhet të jetë i pajisur me certifikatën e servisit lëshuar nga organet kompetente.

*Kërkesa e DST, pika 2.3.8 “Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që disponon Licencë për ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1, është në përputhje dhe në proporcion me nevojat dhe aktivitetet e kontratës si dhe me qëllimin final të kësaj kontrate, pasi licenca VII.3.B.1, **Pika a. i referohet pikërisht ” riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove:”**.*

***Kërkesa e mësipërme bazohet në:** Ligji nr. 9573, datë 03.07.2006, ”për autoriparimin, shitblerjen, depozitimimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” -VKM Nr. 107, datë 10.02.2016, Për një shtesë në VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar. -Udhëzim Nr. 1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi I mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”*

***Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.*

- *Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.*
- *Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*
- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Argumentim i termave të referencës dhe specifikimeve teknike:**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të*



rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Specifikime teknike për motorrë:**

Gjatësia: 2250 mm-2300 mm.

Gjerësia: 800 mm-850 mm.

Lartësia: 1400 mm-1500 mm.

Distanca e akseve: 1400mm-1600 mm.

Lartësia nga toka: 160 mm-180 mm.

Lartësia e shalës: 830 mm-850 mm.

Pesha pa ngarkesë: 200 kg deri 220 kg.

Depozita e benzinës: 20 lt deri në 22 lt.

Vëllimi i motorrit: 600 – 650 CC

Motorri: 4 kohë, ftohje me ujë

Lubrifikimi: Me pompë vaji

Injeksioni: Eletrik

Sistemi ushqimit: Fuel injeksion.

Transmesioni: 6 marshe.

Transmesioni: Zinxhir ose transmision

Fuqia motorike: 50 KW – 55KW

Emisioni Euro 5

Shasia:

Amortizatorët para: Teleskopik me vaj

Frenat para: Doping disk Alkoli

Goma Para: R18 deri më R19 (R18,R19)

Konsumi Karburantit: 4 L – 4.5 L

Ngjyra: E Bardhë

Viti i Prodhimit: Jo më pak se viti 2022, janë motorrë që do të jenë në përdorim për një periudhë të gjatë kohore.

**Shoqëritë ofertuese duhet të përmbushin këto kushte:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së motorrëve (jo më pak se një vit), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e tyre pa pagesë konform specifikimeve teknike. Operatori ekonomik do të marrë përsipër zëvendësimin e çdo pjese në rast defekti që vjen nga prodhuesi për një periudhë 1 vjeçare nga dita e dorëzimit të mallit dhe të marrë përsipër çdo riparim periodik që lidhet me difekte të prodhuesit ose shërbime të tjera. Motorrët duhet të jenë të pajisur me leje qarkullimi, çertifikatë pronësie, siguracion TPL dhe Kasko, taksat vjetore dhe kontrollin teknik. (kolaudimin).

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “**Blerje Motorre për Policinë Bashkiake**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

Dokumentat e tenderit

**NJËSIA E PROKURIMIT**